

Si festohet fillimi i shkollës në Baden-Württemberg

Fillimi i shkollës është një ngjarje e rëndësishme në Gjermani: Fëmija lë kopshtin dhe bëhet fëmijë shkolle. Tranzicioni vjen me ndryshime si për fëmijën ashtu edhe për ju si prind; prandaj, dita e parë e shkollës është një ditë e veçantë. Fillimi i shkollës quhet përndryshe edhe Einschulung (Dita e parë e shkollës).

Për ditën e parë të shkollës, shkolla organizon një festë në të cilën janë të ftuar të gjithë fëmijët që hyjnë në klasën e parë dhe prindërit e tyre (dhe shpesh të afërmit e tjerë). Fëmijët sjellin çantat e tyre me vete – dhe një Schultüte (qese e madhe si dhuratë për ditën e parë të shkollës).

Schultüte është një zakon gjerman i cili është shumë i popullarizuar. Schultüte është shenjë e një fillimi të ri dhe zakonisht i dorëzohet fëmijëve nga prindërit. Mund të punohet, të qepet ose të blihet. Çanta përmban ëmbëlsira, dhurata të vogla ose mjete shkollore (si lapsa me ngjyra ose gomë). Nuk është se përmbajtja është e shtrenjtë, por është një surprizë për fëmijët.

Në festën në shkollë, nxënëset dhe nxënësit më të rritur shpesh performojnë; një shfaqje të shkurtër, për shembull. Drejtoria e shkollës mirëpret prindërit dhe fëmijët. Fëmijët shkojnë në klasën e tyre të re me mësuesen apo mësuesin e tyre. Në shumicën e rasteve mbahet edhe ora e parë mësimore. Ju do të merrni më shumë informacione ndërsa fëmija juaj është në klasë; për shembull, një mësues do t'ju prezantojë orarin. Ju gjithashtu keni mundësinë të takoni prindërit e fëmijëve të tjerë.

Disa shkolla kremtojnë gjithashtu një shërbim të krishterë me rastin e regjistrimit në shkollë. Kjo për shkak të traditës, sipas së cilës në Gjermani njerëzit shpesh kërkojnë bekime hyjnore për faza të reja të jetës (p.sh. për martesë). Prindërit që nuk janë të krishterë janë gjithashtu të ftuar dhe mund të bashkëngjiten - ata nuk janë të obliguar të marrin pjesë.

Mësimi i rregullt zhvillohet ditën e nesërme. Informacione të detajuara për orarin ditor mund të merrni nga shkolla juaj.

